



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova  
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Infrastrukturës  
Ministarstvo za Infrastrukturu  
Ministry of Infrastructure

**Ministri i Infrastrukturës**, në mbështetje të nenit 93(4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me Nenin 6.1 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, nenin 38 paragrafin 6 të Rregullores nr. 09/2011 të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nenin 8 paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 mbi fushat e përgjegjësi administrative të zyrës së Kryeministrit dhe ministrave dhe Marrëveshjen shumëpalëshe për themelimin e hapësirës së përbashkët evropiane të aviacionit,

Nxjerr:

RREGULLOREN Nr. 01/2013  
MBI KODIN E SJELLJES PËR SISTEMET E KOMPJUTERIZUARA TË REZERVIMIT

**Neni 1**

1. Rregullorja (KE) nr. 80/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 14 janarit 2009 mbi Kodin e sjelljes për sistemet e kompjuterizuara të rezervimit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KEE) nr. 2299/89, në tekstin e mëtejshëm Rregullorja (KE) nr. 80/2009 do të aplikohet në Republikën e Kosovës. Rregullorja (KE) nr. 80/2009 i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje.
2. Dispozitat në fuqi të Rregullores (KE) nr. 80/2009 në Republikën e Kosovës janë Nenin 1 deri 16, 17.2, 18 dhe Aneksin I dhe II.
3. Çfarëdo dispozite që amendamenton Rregulloren (KE) nr. 80/2009, siç përcaktohet në Aneksin I të Marrëveshjes shumëpalëshe për themelimin e hapësirës së përbashkët evropiane të aviacionit (HPEA) do të jetë e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

## Neni 2

1. Përkufizimi i termeve dhe shprehjeve të përdorura Nenit 2 Rregullores (KE) nr. 80/2009. Do të vlejë në këtë Rregullore.

2. Pavarësisht paragrafit 1, termet “Komunitet”, “e drejta e Komunitetit”, “legjislacioni i Komunitetit”, “instrumentet e Komunitetit”, “Traktati i KE-së”, “aeropot i Komunitetit”, “Gazeta Zyrtare e Komuniteti Evropian”, “Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian”, “transportues ajror i Komunitetit” dhe “Shtet(et) Anëtar(e)”, nëse përmenden në këtë Rregullore dhe Rregulloren (KE) 80/2009, do të lexohen në përputhje me Pikat 2 dhe 3 të Aneksit II të Marrëveshjes HPEA.

## Neni 3

Në rast të dallimeve midis versioneve të Rregullores (KE) 80/2009 në gjuhën shqipe ose serbe, me versionin origjinal të gjuhës angleze, do të vlejë versioni në gjuhën angleze siç është publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

## Neni 4

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Prishtinë, 22 shkurt 2013

